



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Sigurinë Kombëtare

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 03.03.2014, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Spartak Braho – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

- 1) Miratimi i procesverbalit të datës 04.02.2014.
- 2) Miratimi i kalendarit të veprimtarisë së komisionit për periudhën 3-21 mars 2014.
- 3) Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Zyrës Policore Europiane (EUROPOL) “Për bashkëpunimin strategjik dhe operacional””.

Marrin pjesë:

Spartak Braho, Piro Lutaj, Arben Çuko, Armando Prenga, Paulin Sterkaj, Pjerin Ndreu, Xhemal Qefalia, Taulant Balla, Luan Rama, Ermonela Felaj, Ulsi Manja, Armando Subashi, Ardian Turku, Flamur Noka, Alban Zeneli, Aqif Rakipi, Ylli Shehu, Mesila Doda, Astrit Patozi, Keltis Kruja, Helidon Bushati dhe Arben Ristani.

Mungojnë:

Shkëlqim Selami dhe Vexhi Muçmataj.

Të ftuar:

Ilirjan Mustafaraj – zëvendësministër i Punëve të Brendshme

Gentian Jahjoli – shef i Sektorit të Marrëveshjeve në Ministrinë e Punëve të Brendshme

Artur Beu – specialist në Drejtorinë e Bashkëpunimit Policor Ndërkombëtar

HAPET MBLEDHJA

Spartak Braho – Sot në rendin e ditës kemi shqyrtimin e projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Zyrës Policore Europiane (EUROPOL) “Për bashkëpunimin strategjik dhe operacional””.

Nga ekzekutivi kanë ardhur zotërinjtë: Ilirjan Mustafaraj, zëvendësministër i Punëve të Brendshme, Gentian Jahjoli, shef i Sektorit të Marrëveshjeve në Ministrinë e Punëve të Brendshme, si dhe Artur Beu, specialist në Drejtorinë e Bashkëpunimit Policor Ndërkombëtar. Relatori i kësaj çështjeje nga komisioni është zoti Pjerin Ndreu.

Zoti Ndreu, keni fjalën.

Pjerin Ndreu – Marrëveshja e bashkëpunimit reciprok ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Zyrës Policore Europiane (EUROPOL) është e një rëndësie të veçantë, sepse e shtrin bashkëpunimin në luftën kundër krimit të organizuar dhe llojeve të tjera të kriminalitetit me interes reciprok. Disa nga fushat kryesore janë: trafikimi i paligjshëm i lëndëve narkotike, aktivitetet e paligjshme të pastrimit të parave, trafikimi i qenieve njerëzore, trafikimi i narkotikëve, tregtimi i paligjshëm i organeve dhe indeve njerëzore, trafikimi i paligjshëm në vlerat kulturore, duke përfshirë veprat antike dhe ato të artit, shantazhimin dhe shfrytëzimin, falsifikimin e parave e mënyra e pagesave, si dhe krimi kompjuterik.

Marrëveshja ka 28 nene dhe, duke e ndjekur nen për nen, ajo ka përkufizimet, objektin e bashkëpunimit dhe aspekte të ndryshme, që kanë të bëjnë me mënyrën sesi do të ushtrohet ky bashkëpunim me interes reciprok, duke parashikuar (çka është më e rëndësishmja për t’u evidentuar) shkëmbimin e informacionit, mënyrën sesi do të merret dhe analizohet informacioni, mënyrën sesi do të organizohen analizat dhe kontaktet e ndryshme, që nga nivelet e larta, ato operationale, deri tek trajnimet dhe më pas edhe te pjesa e realizimit të goditjes së kriminalitetit.

Në fund të marrëveshjes janë dispozitat e fundit, të cilat kanë të bëjnë me linjën e sigurt të komunikimit, shpenzimet, mendimet, shtojcat, hyrja në fuqi, vlefshmëria, përfundimi i marrëveshjes, bashkëpunimi strategjik dhe përfundimi i marrëveshjes.

Duke pasur parasysh se lufta kundër krimit është një prioritet i jashtëzakonshëm jo vetëm për vendin tonë, por për të gjithë rajonin, duke qenë se EUROPOL është një

organizatë serioze që vepron në kuadër të BE-së, është në interes të vendit tonë që ne jo vetëm të japim pëlqimin për këtë marrëveshje, por të nxitim të gjitha strukturat tona që ta thellojmë nivelin e bashkëpunimit me EUROPOL-in, duke pasur parasysh se vendi ynë drejtpërsëdrejti do të jetë përfitues në luftën kundër krimit. Prandaj, ju ftoj të gjithëve të jepni pëlqimin për këtë marrëveshje.

Faleminderit!

Spartak Braho – Ka pyetje?

Nuk ka.

Fjalën e ka, përfaqësuesi i ministrisë, zoti Mustafaraj.

Ilirjan Mustafaraj – Unë dua të theksoj vetëm një fakt: ratifikimi i kësaj marrëveshjeje bën që Shqipëria, Policia e Shtetit dhe Ministria e Brendshme, të jenë *de facto* një hap përpara marrjes së statusit, sepse ne nëpërmjet kësaj krijojmë një bashkëpunim efektiv jo vetëm në fushën e shkëmbimit të informacionit, por edhe në atë operacionale. Është një presion i shtuar edhe i EUROPOL-it që kjo marrëveshje të miratohet sa më shpejt, me qëllim që të bëhet efektive, gjithnjë në interes të luftës kundër krimit, parandalimit të tij dhe pjesëmarrjes efektive të të gjithë organizmave ligjzbatuese të Shqipërisë.

Unë mendoj se referenca e zotit Ndreu ishte e plotë. Kërkojmë të miratohet një orë e më përpara, gjithnjë në interes të rritjes së efektivitetit në luftën kundër krimit.

Spartak Braho – Faleminderit! Nga specialistët a ka njeri për të shtuar ndonjë gjë? Nuk ka.

A kanë pyetje anëtarët e komisionit?

Paulin Sterkaj – Një pyetje kam unë: kostoja financiare e kësaj marrëveshjeje, a mund të na e shpjegoni pak sa është?

Ilirjan Mustafaraj – Marrëdhënia me EUROPOL-in, për hir të së vërtetës, ka vite që është duke u zhvilluar. Ne kemi një oficer kontakti në Hagë, atje ku është qendra, kemi gjithashtu përfaqësues të policive të vendeve të ndryshme të Europës në Shqipëri. Kostoja financiare në këtë rast është ajo që ka qenë deri më sot. Nuk ka asgjë më shumë. Të gjitha ato kërkesa janë plotësuar, sidomos në arritjen e standardeve të ruajtjes së informacionit të klasifikuar dhe në mbrojtjen e të drejtave të të dhënave individuale. Janë bërë disa investime. Është instaluar një sistem modern, SIENA qysh në vitin 2012.

Kështu që nuk shoh ndonjë shtesë të buxhetit në lidhje me këtë marrëveshje. Nuk ka. Tani çështja qëndron vetëm që të mundemi të vjelim sa më shumë informacion nga partnerët tanë të vendeve të ndryshme të Europës të përqendruara te Zyra e Policimit të Europës, që quhet EUROPOL.

Spartak Braho – Pyetje tjetër?

Urdhëro!

Helidon Bushati – Ka dy marrëveshje të mëparshme me EUROPOL-in, njëra është e 2007-s “Për bashkëpunimin strategjik”, kurse tjetra është e 2009-s “Për oficerët e kontaktit”. Në vetvete kjo marrëveshje e sotme, desha të di nëse është thjesht një integrim i tyre, apo sjell një risi ndaj atyre dy të tjerave që kanë qenë në vitet 2007-2009?

Artur Beu – Ju faleminderit!

Në lidhje me efektet e marrëveshjes vetëm për bashkëpunimin strategjik dhe marrëveshjes në lidhje me pikën tonë të kontaktit pranë zyrës së EUROPOL-it, efekti i marrëveshjes së re është efekt në vazhdimësi, pra të gjitha, bashkëpunimi dhe arritjet e deritanishme, përthithen nga kjo marrëveshje. Zëvendësohet marrëveshja për hir të parimit të sigurisë juridike dhe për të respektuar edhe ngjashmërinë me vendet e tjera, të cilat i janë nënshtruar këtij procesi. Pra, për të pasur vetëm një marrëveshje unike dhe për të zëvendësuar, le të themi, bashkëpunimin e vjetër me format më të reja të bashkëpunimit. Në planin praktik ka një vazhdueshmëri, asgjë nuk ndryshon. Pra, arritjet e deritanishme zbatohen dhe do të ngrihen në nivelin e një bashkëpunimi gati me vendet anëtare.

Helidon Bushati (*Flet pa mikrofon, por dëgjohet në sfond.*) – Kjo marrëveshje është integruese e atyre të mëparshme në një dokument të vetëm juridik, por nuk sjell ndonjë risi... Edhe e 2007-s, edhe e 2009-s vazhdojnë efektet e tyre dhe kjo është integruese.

Artur Beu – Po, është integruese.

Spartak Braho – A ka pyetje tjetër?

Në parim kush është dakord?

Neni 1 dakord.

Neni 2 dakord.

Zoti Ilirjan, faleminderit dhe suksese!

Ilirjan Mustafaraj – Faleminderit edhe ju!

(Diskutime pa mikrofon.)

Spartak Braho – Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës: miratimi i kalendarit për veprimtarinë e komisionit për periudhën 3 mars-21 mars 2014. Në kalendar është parashikuar që ditën e martë, pra nesër, komisioni do të japë mendim lidhur me projektligjet “Për Policinë e Burgjeve” dhe për dhënien e amnistisë.

Ditën e mërkurë, datë 5 është parashikuar raportimi i kryetarit të SHISH-it, zotit Visho Ajazi, në bazë të detyrimit ligjor që ka për të raportuar për veprimtarinë e SHISH-it për vitin 2013. Një raportim që bëhet pranë Komisionit një herë në vit.

Pika 2, “Informacion rreth problematikës së ngritur në një emision televiziv, kanali ORA NEWS, për shkeljen e ligjit “Mbi emërimin e drejtorit të SHISH-it”, kërkuar nga deputetët e majtë, Xhemal Qefalia”.

Pika 3, “Informacion lidhur me bashkëpunimin e Shërbimit Informativ dhe të Ministrisë së Brendshme për çështjet e ngritura në kërkesën e deputetëve të PD-së”.

Ditën e martë është projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së bashkëpunimit ushtarak financiar ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, qeverisë së Republikës së Turqisë dhe të protokollit “Zbatime të ndihmës financiare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Turqisë”. Po ditën e martë kemi “Për dhënie mendimi lidhur me projektligjin “Për kujdesin shëndetësor të veçantë të punonjësve të strukturave speciale operationale të Policisë së Shtetit”. Po ashtu, është edhe projektligji “Mbi disa ndryshime dhe shtesa të ligjit nr. 10192 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar të trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”. Kemi për të dhënë mendim.

Jemi dakord me kalendarin?

Flamur Noka – Grupi i deputetëve të opozitës prej kaq kohësh ka kërkuar që drejtori i SHISH-it të vijë e të raportojë në lidhje me bashkëpunimin e SHISH-it me Ministrinë e Brendshme për çështjet e ngritura dhe kryesisht për rendin dhe sigurinë në vend dhe për çështjen e ngritur nga ana e zotit ministër të Brendshëm në lidhje me faktin që SHISH-i, sipas pretendimit, ka problematikë në bashkëpunimin me Ministrinë e Brendshme. Kjo ka qenë e gjithë kërkesa jonë e bazuar mbi akuzat që lëshoi ministri i Brendshëm. Kemi kërkuar që drejtori i SHISH-it të vijë dhe të raportojë.

Shoh që në këtë pikë është bashkëngjitur edhe një kërkesë tjetër, e cila nuk ka lidhje me atë që kemi parashtruar ne dhe që sigurisht unë gjykoj që veprimtaria e SHISH-it, kuadri ligjor që e fokuson veprimtarinë dhe funksionin e SHISH-it, dhe akuzat, apo sqarimi i akuzave të ministrit të Brendshëm ndaj SHISH-it, janë çështja kryesore për të cilën kemi kërkuar që kryetari i SHISH-it të vijë të raportojë.

Në lidhje me kërkesat tjera, që është e parashtruar këtu, një informacion rreth problematikës së ngritur nga deputeti Qefalia, shumë mirë mund ta thërrasim drejtuesin e SHISH-it në një seancë të veçantë. Sikundër kemi kërkuar që të thirret në një seancë të veçantë vetëm për këtë problematikë që kemi parashtruar.

Spartak Braho – Vendosim me votim. Lidhur më kërkesën e deputetit Qefalia, a ka njeri tjetër për të diskutuar?

Kush është dakord?

Flamur Noka – Më fal! Se si thërritet në interpelancë, zoti kryetar...

Spartak Braho – Në seancë dëgjimore.

Flamur Noka – ...në seancë dëgjimore, më fal... e dimë mirë, sepse e përcakton Rregullorja. Se si thërritet një drejtues institucioni në seancë dëgjimore e përcakton Rregullorja. Dhe Rregullorja e përcakton numrin e deputetëve që duhet të firmosin... Vetëm deputeti Qefalia... Nuk besoj se është në përputhje me Rregulloren vetëm kërkesa e deputetit Qefalia.

Paulin Sterkaj – A mund ta them unë një fjalë. Jemi dakord me opozitën që ka thirrur kryetarin e SHISH-it, për të dhënë shpjegime për sa u përket marrëdhënieve dhe bashkëpunimit me Ministrinë e Brendshme, por asnjëherë nuk ka të drejtë opozita që të na e heqë ne të drejtën për të thirrur ne kryetarin e SHISH-it për të na dhënë llogari. Këtu nuk është parlamenti i opozitës. Këtu është parlamenti i të gjithë deputetëve, ku gjithsecili prej nesh ka të drejtë ligjore, sipas Rregullores, për ta thirrur atë.

Nuk jam në debat me ty, Flamur, sepse kam rezerva, nëse e fillojmë debatin.

Flamur Noka – Më fal, se nuk dua të keqkuptohemi. Unë parashtroj si çështje të rëndësishme se ne si deputetë të opozitës kemi kërkuar prej kohësh, madje është e vonuar, kërkesa që i është dërguar nga ana e komisionit drejtorit të Shërbimit për t'u paraqitur në një seancë dëgjimore.

Spartak Braho – E miratuar atë.

Flamur Noka - Më falni! Çështja për të cilën ne e kemi kërkuar, gjykojmë se është mjaft e rëndësishme, pasi janë hedhur akuza të rënda në drejtim të SHISH-it, në lidhje me veprimtarinë dhe funksionimin e këtij institucioni në këtë periudhë. Janë hedhur akuza ndaj këtij institucioni, në lidhje me mosbashkëpunimin me Ministrinë e Brendshme dhe këto akuza janë shumë të rënda, pasi janë hedhur nga ministri i Brendshëm. Duke marrë parasysh situatën kriminale shumë të rënduar, duke marrë parasysh edhe për të sqaruar domosdoshmërinë që kemi, jo vetëm ne si deputetë të opozitës, por edhe opinionin, një situatë të tillë dhe këtë lloj forme bashkëpunimi të detyrueshme ligjore që është me institucionet, ne kemi çmuar që është mjaft e rëndësishme që të zhvillojmë një seancë të posaçme me kreun e Shërbimit dhe sigurisht që do të jemi dakord që të thirret edhe për arsyen që ka kërkuar zoti Qefalia, edhe për çdo arsye tjetër. Unë them që të mos të keqkuptohemi t'i ndajmë seancat, pasi seancën, për të cilën e kemi thirrur e çmojmë mjaft të rëndësishme.

Pra, nuk jemi kundër, që të kuptohemi, jemi që të ndajmë seancat, sepse seanca është shumë e rëndësishme.

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Xhemal Qefalia - Faleminderit zoti kryetar! Unë nuk dua të kaloj në replikë me kolegun Noka, vetëm dua t'i them se në Rregulloren e parlamentit është e përcaktuar fare qartë se si lind kërkesa për të ftuar në seancë dëgjimore krerët e institucioneve. Nëse jeni apo nuk jeni dakord grupi juaj për ta thirrur kryetarin e SHISH-it kjo nuk ka aspak rëndësi. Nuk kam pse ta di për nder unë se jeni ju dakord. Këtu po shtrohet një problem që kryetari i SHISH-it do të vijë pranë komisionit dhe e ka detyrë kushtetuese që të raportojë përpara komisionit. Në këtë seancë që do të vijë për të raportuar, për aktivitetin 1-vjeçar, do t'u përgjigjet edhe pyetjeve që keni bërë ju si opozitë, edhe kërkesës që ka bërë deputeti, një e drejtë kushtetuese e bazuar edhe në rregullore. Kështu që nuk kemi pse ta kthejmë një ditë të vitit për ju, një ditë për ne. Ky është një vendim që kishit marrë. Ai do të jetë prezent, ju keni të gjithë hapësirën ligjore dhe kohën e nevojshme të mjaftueshme për të bërë pyetjet lidhur me problemet që keni ngritur. Unë edhe grupi i Partisë Socialiste ka të gjithë të drejtën dhe hapësirën kohën e nevojshme për të bërë pyetjet e duhura. Çfarë ka këtu për ta kthyer në arenë debatesh?

Spartak Braho – Të zbatojmë rregulloren.

Kush është dakord me miratimin e kërkesës për të raportuar kryetari i SHISH-it mbi bazën e kërkesës që ka bërë Partia Demokratike dhe Grupi i Partisë Socialiste?

Piro Lutaj - Faleminderit zoti kryetar! Mbase është e nevojshme ta them dhe unë mendimin tim. E kemi të gjithë përpara planin e punës të komisionit për ditën e mërkurë dhe, sigurisht, ai është formatuar në bazë të arsyetimeve që keni bërë lidhur me kërkesën e dy kolegëve. Unë e konsideroj të plotë këtë për sa është shkruar, por ndërkohë unë dua zoti kryetar, dhe i kërkoj komisionit që në pikat ku do të raportojë kryetari i SHISH-it, ditën e mërkurë, të parashikohet edhe një problem tjetër i ekspozuar ditët e fundit, i bërë madje shumë mediatik, që lidhet shumë me një informacion të kërkuar urgjent nga kryetari i SHISH-it për drejtuesit kryesorë të emëruar në Policinë e Shtetit. Besoj se çdokush prej nesh do të ishte mjaft i interesuar të dinte se çfarë ka zbuluar kryetari i SHISH-it lidhur me këto emërime, prandaj i propozoj komisionit të futet në një nga pikat që do të raportojë. Përveç këtyre, të futet edhe raportimi i kryetarit të SHISH-it lidhur me këtë shkresë që sapo citova.

Ndërsa, siç e tha dhe kolegu Qefalia, ne, në qoftë se do të mbetemi këtu për të debatuar për pikat e programit mund të zgjatemi ditë të tëra. Këtu rregullisht është të hidhet në votë. U dha një mendim nga kolegu Noka që të kufizohet problematika e thirrjes së kryetarit të SHISH-it, ndërkohë ne krahu tjetër kemi mendimin që të zgjerohet problematika dhe të parashikohen dy çështjet përkatës, një e trajtuar nga zoti Qefalia dhe një sapo e citova unë, të hidhet në votë, të miratohet bëhet programi dhe ne të fillojmë punë.

(Diskutime pa mikrofon)

Flamur Noka – Unë po shoh se këtu nuk po kapet thelbi. Çështja nuk është se opozita nuk është dakord të thërritet edhe për çështje të tjera. Por në momentin që në pikën e parë kemi vendosur që të vijë e të raportojë mbi veprimtarinë e Shërbimit për vitin 2013, do të thotë se në veprimtarinë e tij përfshihen të gjitha dhe s'ka nevojë të futen pika të veçanta. Pikë e veçantë është vetëm kërkesa e opozitës në lidhje me një çështje shumë specifike, në bashkëpunimin me Ministrinë e Brendshme dhe të sqarojë pozicionin e institucionit në lidhje me akuzat që ka hedhur ministri i Brendshëm në drejtim të tij.

(Diskutime pa mikrofon)

Pse ne kërkojmë që kjo të bëhet në seancë të posaçme? Sepse ne e çmojmë si shumë të rëndësishme këtë gjë, këtë lloj funksionimi, këtë lloj bashkëpunimi. Dhe kjo s'është e rëndësishme për ne, po për të gjithë opinionin. Megjithatë, ju doni ta thërrisni për të gjitha. Ka një problem që shoh te kërkesa e maxhorancës. Synimi është për të krijuar një mjegullnajë të përgjithshme dhe për të eklipsuar çështjen themelore rreth së cilës ka kaq kohë që bëhet zhurmë, e për të cilën ne dhe opinioni kemi nevojë të dalë e vërteta në dritë. Kjo më shqetëson për faktin se kërkon të krijojë një mjegullnajë. Megjithatë, ju keni shumicën, dakord, bëjeni!

(Diskutime pa mikrofon)

Taulant Balla – Zoti nënkryetar dhe ju zoti kryetar! Rregullimin e seancave dëgjimore e bën Rregullorja e Kuvendit, dhe çështjet që parashtrihen në seancën dëgjimore nuk diskutohen në mbledhje të komisionit, por diskutohen ndërmjet kryetarit, nënkryetarit dhe sekretarit. Neni 36 paragrafi 2, më lejoni ta citoj: “Në përgatitjen e seancës dëgjimore publike, kryetari në bashkëpunim me zëvendëskryetarin dhe sekretarin e komisionit i paraqet të ftuarve çështjet për të cilat kërkohet informacion”. Kështu që çdo deputet i komisionit, nëse mendon se duhet të shtrojë çështje të tjera për t'u ezauruar në seancën dëgjimore me kryetarin e Shërbimit Informativ Shtetëror, t'ia paraqesë kryesisë së komisionit, që përbëhet nga ju të tre, sigurisht edhe me ndonjë anëtar tjetër të komisionit që mendon se ka ndonjë çështje tjetër për t'u ezauruar. Ne nuk mund të bëjmë shtatëmbëdhjetë, njëzet seanca dëgjimore me një institucion, kur në një seancë dëgjimore mund të ezaurohen të gjitha çështjet, sipas nenit përkatës të Rregullores. Në parim dhe në traditën parlamentare ndiqet ky rregull: çështja juaj është çështja e parë, sepse është çështja e parë e paraqitur për dëgjim. Sigurisht, të gjithë deputetët e këtij komisioni, sigurisht dhe shqetësimi që ngriti zoti Lutaj. Ne deputetët e pozitës jemi shumë të shqetësuar për diçka që është publikuar në media, e cila nuk është vetëm çështje e karakterit të Shërbimit Informativ, por më shumë se kaq, është një çështje e një sulmi politik. Këto do t'i diskutojmë të gjitha bashkë, por përgatitja e pyetjeve që i paraqitet drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Informativ Shtetëror nuk është çështje për vendim

në komision. Çdo deputet, qoftë ky i minorancës, qoftë i pavarur, ka të drejtë të bëjë pyetje, ndërsa ju si juri e komisionit keni detyrë ta paraqisni për parashtrim. Besoj se ajo për të cilën biem dakord është se çështja që ju keni shtruar është çështja e parë e rendit të ditës në atë seancë dëgjimore, dhe besoj se këtu ezaurohet gjithë debati për këtë çështje.

Spartak Braho – Mirë atëherë, një kundër, një pro.

Flamur Noka – Nuk do ta bëjmë debat. Më falni, ju kërkoj ndjesë, por faleminderit, zoti Balla! Unë nuk desha të hyja në detaje teknike, por po ju sqaroj. Siç e thatë ju, çështja e parë e rendit të ditës duhej të ishte kërkesa jonë, por që është e treta.

Spartak Braho – Jo, jo, e dyta.

Flamur Noka – Është e treta.

Spartak Braho – E dyta, është vënë gabimisht e treta.

Flamur Noka – Mirë, është e treta këtu dhe duhej të ishte e para.

Dhe e dyta, për këtë kalendar, Rregullorja po ashtu e përcakton se duhej të rakordonin kryetari, nënkryetari dhe sekretari. Në fakt, unë nuk është se jam rakorduar, por nuk po e bëjmë zhurmë të madhe këtë histori. Por e rëndësishme është që kërkesa jonë të jetë pika e parë dhe pastaj të vazhdojmë. A biem dakord me këtë, zoti kryetar?

Spartak Braho – Tani, në zbatim të rregullores bëhen propozimet, dëgjohet një mendim pro, një mendim kundër dhe pastaj votohet. Por, para se ta votoj, unë doja të shtroja diçka tjetër, e cila ka të bëjë me mënyrën që do të ndjekim ne për raportimin e kryetarit të SHISH-it. Për shkak të rëndësisë problematikës, ju propozoj që pasnesër raportimi i kryetarit të jetë me dyer të mbyllura. Pra, bashkë me votimin e çështjeve që do të thirren në raport, propozoj që ndjekja dhe raportimi të jenë me dyer të mbyllura. Kush është dakord?

Flamur Noka – Zoti Kryetar, më fal! Në rast se doni ta bëni me shumicë apo dhunë kartonësh, bëjeni, është çështja juaj! Por, e vërteta është se ne duhet të ishim konsultuar; kryetari me nënkryetarin dhe sekretarin edhe për këtë çështje dhe ajo që është më e vërtetë, mbi të gjitha, është se për kërkesën që deputetët e opozitës kanë paraqitur në komision, kanë nevojë të gjithë qytetarët të ketë transparencë dhe ta shohin të vërtetën, në rast se kreu i shërbimit ka fajë apo rëndojnë mbi të akuza të ngritura nga ministri, apo ministri ka gënjyer në lidhje me situatën. Jo vetëm ne, por edhe qytetarët kanë të drejtë të shohin, në lidhje me çështjen që kanë parashkruar deputetët e opozitës, për të thirrur në

seancë dëgjimore kryetarin e Shërbimit. Ne kërkojmë që kjo të jetë mediatike dhe transparente, që shqiptarët të shohin nëse ka gënjyer ministri, apo ka fajë dhe mban përgjegjësi kryetari i Shërbimit.

Faleminderit!

Paulin Sterkaj – Kam diçka për procedurë.

Ne do ta lemë çmimin e kryetarit të SHISHI-t, sepse ai e di mirë se çfarë është material i klasifikuar e çfarë jo. Por jo të vendosësh ti, Flamur, se na je bërë sikur je baba i këtij komisioni! Ky komision ka rregullore dhe parlamenti ka edhe ligje.

Spartak Braho – Mua më vjen keq Flamur, për ty dhe për Albanin, që jeni marrë me këto punë. Ju e dini se shumë çështje atje janë të karakterit sekret shtetëror dhe unë nuk marr përsipër të shkel ligjin dhe ta bëjmë sekretin shtetëror pronë të tërë miletit, prandaj, duhet të jini me këmbë në tokë! Komisioni do të diskutojë hapur këtu, do të nxjerrim përfundime të cilat do t’ia japim medias, por ne s’mund të diskutojmë çështje të cilat janë të klasifikuara.

Flamur Noka - Më falni, zoti kryetar!

Askurrkush nuk ka kërkuar që këtu të vijnë dhe të raportohen çështje që janë sekret shtetëror mediatikisht. Ne kemi kërkuar të përgjigjet drejtori i Shërbimit në lidhje me akuzat që janë hedhur në drejtim të tij dhe institucionit që ai drejton nga ana e ministrit të Brendshëm. Vetëm këtë. Dhe pastaj, pjesa tjetër, sigurisht që duhet të vazhdojë me dyer të mbyllura. Ne dhe qytetarët kemi nevojë për këtë transparencë dhe ky nuk është sekret shtetëror. Sekretet shtetërore, ne e dimë shumë mirë dhe të gjithë biem dakord, nuk mund të jenë transparente dhe duhet të diskutohen me dyer të mbyllura.

Spartak Braho - E ka kërkuar vetë kryetari i Shërbimit me dyer të mbyllura. Ai do vijë të nxjerrë sekrete këtu?!

Alban Zeneli - Nuk është e drejtë insinuata juaj për SHISH-in. Unë jam shumë dakord me deputetin Sterkaj dhe me mënyrën se si duhet të raportojë kryetari i SHISH-it. E di ai më mirë se ne se çfarë është sekret shtetëror.

Spartak Braho - Nuk e di ai më mirë se ne, se po ta dinte më mirë se ne nuk do të çonte shkresa poshtë e përpjetë.

Alban Zeneli - Këto janë insinuata. Ai do të vijë këtu e do të thotë për publikun atë që duhet t’i jepet publikut. Çfarë është sekret, do të mbetet sekret.

Flamur Noka - Më falni, të mos bëjmë kakofoni këtu! Nuk po themi asgjë më tepër se përcakton ligji. Të bëjë transparencë në lidhje me bashkëpunimin mes dy institucioneve: Ministrisë së Brendshme dhe Shërbimit Informativ Shtetëror dhe pjesa e raportit për veprimtarinë të jetë e gjitha e mbyllur për mediet. Kaq po kërkojmë.

Spartak Braho - Mbyllim mbledhjen.

MBYLLET MBLEDHJA